



497
23 12 14

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare

Datë: 17.12.2014

Në përputhje me nenin 2, paragrafi 2.2 të Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenin 3, paragrafi 5 nënparagrafi b.a të Ligjit nr 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe nenin 22 të Udhëzimit Administrativ nr. 17/2013 për Licencimin e Subjekteve Juridike/Organizatave që Ofrojnë Shërbime Sociale dhe Familjare, ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, merr këtë:

V E N D I M

1. Çdo subjekt juridik/organizatë që parashtron kërkesë për Licencim për ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare, përmes së cilës i mundësohet ofrimi i shërbimeve sipas legjislacionit në fuqi dhe standardeve minimale të shërbimeve sociale dhe familjare, në emër të taksës administrative do të paguaje një shumë të caktuar të mjeteve financiare.
2. Lartësia e mjeteve financiare për pagesë në emër të taksës administrative, për çdo parashtrues të kërkesës (subjekt juridik/organizatë) për Licencim, do të paguaj 30.00 € (tredhjetë euro).
3. Pagesa për Licencë nga parashtruesi i kërkesës (subjekt juridik/organizatë) duhet të bëhet në ndonjërin nga bankat komerciale, në xhirollogarinë e caktuar nga MPMS.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit përgjegjës, dhe
- Arkivit të DPSF/ MPMS

